Letërsia shqiptare

Përkthime në gjuhët e Bashkimit Europian
dhe të Ballkanit Perëndimor (2015-2020)

POETEKA

Balkan
Translations
Collider

Letërsia shqiptare

– përkthime në gjuhët e Bashkimit Europian dhe të Ballkanit Perëndimor –

---

të dhëna, vëzhgime dhe analiza:
autorë / përkthyes / botues / libra / revista letrare

2015 - 2020

Co-funded by the
Creative Europe Programme
of the European Union

Përgatitur nga: Prof.univ.dr. Ardian Kyçyku

Lektura e korrektura: Erjena Cenko

Art Design: Intergrafika

Tiranë, 2021

ISBN 978-9928-230-47-8

Copyright © Poeteka, 2021

This publication is for free distribution.
Ky publikim është për shpërndarje falas.

Ky studim botohet me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian, në kuadër të projektit me titull në origjinal *Balkan Translations Collider*, bashkëfinancuar nga Programi *Europa Krijuese* e Bashkimit Europian. Përmbajta e tij është përgjegjësi e autorit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet apo qëndrimet e Bashkimit Europian.

Falënderime

Në mbarëvajtjen e hartimit të këtij materiali ndihmuan veçanërisht Astrit Beqiraj (të cilin e falënderojmë për ekspertizën udhëzuese dhe mbikëqyrjen përgjatë zhvillimit të studimit), Arian Leka (të cilit i shprehim mirënjohjen për këshillimet cilësore dhe sugjerimet e lëndës teorike), sikurse edhe Naile Mala-Imami, Matteo Sabato, Silvana Leka, Rigels Halili, Bashkim Shehu, Livio Muci, Mihaela Vazzolla, Lindita Ahmeti, Lulzim Haziri, Daim Miftari, Rusana Bejleri, Olimbi Velaj, Merima Kriezi, Sali Bytyqi, Zuzana Finger, Eleana Zhako, Dorota Horodyska, të cilëve u shprehim po ashtu mirënjohjen për të dhënat me vlerë si dhe ndihmën e ofruar me bujari. Këtyre u bashkëngjiten edhe autorë e përkthyes shqiptarë, me të cilët shkëmbyem mendime për saktësimin e të dhënave.

Përmbajtje

Autorë nga Kosova 7

I. Metodologjia, synimet, kategori, kritere,
vështirësi të hasura gjatë hulumtimit 8

1. Info 8

2. Synimet 15

3. Kategori dhe kritere 16

5. Përmbajtja e studimit 17

II. Vëzhgime cilësore 19

Vëzhgim panoramik dhe analizë e të dhënave 19

Disa përfundime: 24

Conclusions: 26

Rekomandime: 28

Recommendations: 30

Bibliografi e zgjedhur 32

- Grafik: Autorë shqiptarë (nga Shqipëria, Kosova,
Maqedonia e Veriut dhe Diaspora) / libra të përkthyer /
ribotime / prani në organe shtypi 36

- Listë emërore e autorëve shqiptarë (nga Shqipëria, Kosova,
Maqedonia e Veriut dhe Diaspora) – libra të përkthyer /
ribotime /prani në organe shtypi 37

- Grafiku i frekuencës së përkthimeve
nga shqipja në gjuhët e studiuara 2015-2020,
përfshi prirjet e vitit 2021 41

- Grafiku i frekuencës së përkthimeve nga shqipja në gjuhët
e studiuara (autorë nga Kosova), 2015-2020,
përfshi prirjet e vitit 2021 42

- Tabela e ecurisë të përkthimeve nga autorët shqiptarë (2015-2020) dhe prirjet e tyre (2021) 43

-Grafiku i ecurisë të përkthimeve nga autorët shqiptarë (2015-2020) dhe prirjet e tyre (2021) 44

– Autorë nga Kosova –

Hyrje paraprake:

I. Metodologjia, synimet, kategori, kritere, vështirësi të hasura gjatë hulumtimit

1. Info

Në krye të studimit mbi të dhënat e mbledhura nga autorët shqiptarë të Kosovës, që shkon bashkëlidhur me pjesën e autorëve nga Shqipëria për projektin me titull në origjinal *Balkan Translations Collider* (bashkëfinancuar nga programi *Europa Krijuese* i Bashkimit Europian që, gjatë periudhës 2021-2023, po të zbatohet në Shqipëri nga Shoqata „Poeteka") – theksojmë se kemi ndjekur të njëjtat parime metodologjike për shqyrtim, në përputhje me synimet e kërkimit tonë: pasqyrim shkencor i qëllimeve themelore të projektit.

Kështu, për shembull, zona kohore dhe gjeografike e studimit ka mbetur e njëjtë, sikurse edhe kriteret e analizimit të të dhënave të mbledhura, mbi të cilat u kryen vëzhgime, u nxorën përfundime dhe rekomandime.

Pjesë e shqyrtimit ishin të dhënat analitike, paraqitur në këtë studim përmes tabelave përshkruese, në bazë të të cilave mundëm të japim një pamje të gjendjes aktuale të letërsisë nga Kosova, përkthyer në gjuhët e vendeve të Bashkimit Europian dhe të Ballkanit Perëndimor. Përmes tyre kemi synuar që të ndikojmë në forcimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit të botës letrare shqiptare të Kosovës, e cila, përmes letërsisë së përkthyer, i bashkohet hartës kulturore të Bashkimit Europian dhe Ballkanit Perëndimor.

Jemi të vetëdijshëm se paraqitja në fjalë nuk mjafton, nëse bashkë me arritjet nuk nxirren në pah edhe vështirësitë specifike të letërsisë shqiptare të Kosovës, problematikat që ndeshin përkthyesit, botuesit dhe operatorët e tjerë të fushës gjatë procesit të përkthimit dhe promovimit të librit.

Pjesë e rëndësishme e vëmendjes sonë në këtë studim kanë qenë vendi dhe roli që luajnë përkthyesit letrarë dhe sa e mbështetur, e motivuar apo e vlerësuar është puna e tyre nga institucionet publike dhe private të fushës.

Sikurse edhe në pjesën kushtuar letërsisë së përkthyer nga Shqipëria, qëllim parësor gjatë studimit mbetet fakti që të dhënat dhe përfundimet e tij të bëhen sa më të vlefshme për partnerët vendas e të huaj që veprojnë në fushën e përkthimit të letërsisë shqiptare të Kosovës drejt gjuhëve të vendeve të BE-së dhe të Ballkanit Perëndimor.

Prej këtej synohet që, përveç aktualizimit dhe adresimit, të identifikohen edhe instrumentet më efikas në mbështetje të përkthimit, të bëhen të njohur entitetet dhe (f)aktorët që kanë dëshmuar sukses në rrugën e tyre si ndërmjetësues gjatë procesit të përkthimit dhe botimit të librit të përkthyer (agjenti letrar, revistat letrare, shoqatat apo agjencitë e promovimit, autorë, përkthyes, këshillues të librit në media, gazetarë kulture e agjentë letrarë të synuar, festivale, panaire, botues, shoqata etj.), duke sjellë një ndihmesë në njohjen dhe përforcimin e rrugëve, mjeteve, mënyrave dhe infrastrukturës që rrisin performancën e paraqitjes së një vepre letrare të përkthyer, në rrugën e saj drejt audiencës së gjuhëve pritëse të përkthimit, të tilla si Ministria e Kulturës, Shoqata e Përkthyesve, Shoqata e Botuesve, programet europiane dhe rajonale që mbështesin përkthimit si mjet njohjeje e zhvillimi të gjithanshëm përmes letërsisë.

Kemi bindjen se rezultatet e këtij studimi janë vetëm një pikënisje për një stad të ri pune me librin e përkthyer, pasi njohja paraprake me gjendjen është arritur përmes të dhënave statistikore dhe përpunimit të tyre. Njëherazi, shpresojmë që studimi të shërbejë si bazë të dhënash për strategjitë dhe bashkëpunimet në të ardhmen.

Përsa u përket praktikave të veprimit, edhe për letërsinë shqipe të autorëve nga Kosova u ndoqën të njëjtët hapa si të autorëve nga Shqipëria, proces ky që u fokusua në tri drejtime:

- vjelja e të dhënave;
- përpunimi dhe trajtimi i tyre nëpërmjet vëzhgimit;
- analizimi dhe nxjerrja e përfundimeve, sugjerimeve dhe rekomandimeve.

Rrugët e kërkimit që u ndoqën për shqyrtimin e të dhënave ishin:

I. *online* (Bibliotekat Kombëtare, të cilat ofruan të dhëna të mjaftueshme, të dobishme e orientuese, por jo gjithmonë të pasura e të plota, por në aktualizim e sipër, përsa u përket shteteve dhe gjuhëve të analizuara për efekt të këtij studimi);

II. *kërkim i drejtpërdrejtë* në *Bibliotekat Kombëtare*;

III. *komunikim i drejtpërdrejtë* me kolegë *botues*, *përkthyes* e *autorë* dhe *bashkëpunëtorë* të jashtëm të përfshirë në këtë projekt studimor.

Këtyre rrugëve iu bashkuan edhe këshillimet me bibliografë, historianë të letërsisë, njerëz të mediave dhe të tjera palë të interesuara, kudo ku mundësia për vjelje të dhënash ishte më e kufizuar.

Edhe përsa i përket zonës gjeografike të përkthimit, studimi shqyrtoi hartën kulturore të të gjitha vendeve të BE-së, pavarësisht nëse në to u gjetën apo jo të dhëna mbi përkthimin e autorëve nga Kosova.[1]

1. Të dhënat që vijnë nga shtete si Austria, Zvicra dhe Belgjika janë analizuar mbi kriterin e gjuhës (brenda gjuhëve gjermane dhe franceze).

Si kriter metodologjik klasifikimi, sikurse edhe për rastin e letërsisë së përkthyer në Shqipëri, janë përdorur termat e *dendësisë së shkëmbimit mes gjuh*ës amtare (origjinale të tekstit) dhe gjuhës pritëse në përkthim. Lidhur me këtë janë veçuar tri zona përkthimore, në të cilat letërsia e shkruar në gjuhën shqipe mbërrin:

a) *zona e shkëmbimit të lartë* – gjuhë me frekuencë të lartë në përkthim, në të cilat *tani* përfshihen italishtja, suedishtja, serbishtja, anglishtja e frëngjishtja;

b) *zona e shkëmbimit të mesëm* – gjuhë me frekuencë të moderuar në përkthim, në të cilat *tani* përfshihen bullgarishtja, rumanishtja, gjermanishtja, hungarishtja, polonishtja;

c) *zona e shkëmbimit të ulët* – gjuhë me frekuencë të ulët në përkthim, në të cilat *tani* përfshihen çekishtja, sllovakishtja, kroatishtja, greqishtja, holandishtja, finlandishtja, danishtja, norvegjishtja, gjuha boshnjake etj.[2]

Mendojmë se mënyra e mësipërme e klasifikimit i bën më të dallueshme prirjet dhe tiparet për rritje, zhvillim, dendësim apo rënie të marrëdhënies në përkthimin e letërsisë së autorëve shqiptarë nga Kosova dhe përkthimit të tyre në gjuhët e BE-së e të Ballkanit Perëndimor.

Nisur nga kriteri i *zonave të shkëmbimit*, mbërrihet në stadin e *intensitetit të shkëmbimit*. Këto kritere e përqendrojnë studimin mbi termat e kodifikuar, të cilët i lënë shumë pak vend subjektivitetit, si:

— *letërsi e mirënjohur* (referuar letërsisë shqiptare të përkthyer e të botuar në Itali, Serbi, Maqedoni e Veriut, Francë, Rumani, Gjermani etj.);

— *letërsi e njohur* (referuar letërsisë shqiptare të përkthyer dhe botuar në Suedi, Spanjë, Bullgari, Poloni etj);

2. Ilustrimi i emërtesave dhe termave të përdorur për tri kategoritë mbështetet në skedarët dhe tabelat që shoqërojnë bashkëlidhur këtë studim.

— *letërsi pak e njohur* (referuar letërsisë shqiptare të përkthyer dhe botuar në Çeki, Sllovaki, Kroaci, Slloveni, Hungari, Greqi, Holandë, Finlandë, Danimarkë, Norvegji, Bosnjë-Hercegovinë etj.).

Kësisoj, edhe temat "letërsi të vogla", "letërsi të mëdha", "gjuhë minore" apo edhe "literaturë e njohur / e panjohur" paraqiten si referenca dhe kodifikues ndërkombëtarë, përdorur, mes të tjerësh, nga Gilles Deleuze dhe Felix Guattari[3] për të identifikuar se *nga* dhe *si* ndryshon në thelb një „letërsi e madhe" prej një „letërsie të vogël" dhe *ku* janë dallimet mes një letërsie të shkruar në një „gjuhë të vogël" dhe asaj të shkruar në një „gjuhë të madhe".

Për letërsinë e autorëve shqiptarë nga Kosova nuk kemi përdorur logjikën e termit "autor-qendër", si në rastin e studimit të autorëve nga Shqipëria, pasi në këtë rast termi nuk ruan barazvlefshmëri me kontekstin që Jana Bukova[4] i jep atij.

Kjo optikë e ka çliruar këtë pjesë të studimit edhe nga terma konotativë si "letërsi të vogla", "gjuhë minore", duke ruajtur terma më të stabilizuar, si letërsi *e mirënjohur*, letërsi *e njohur* dhe letërsi *pak e njohur*.

Nisur nga më sipër, gjykuam se për letërsinë e autorëve shqiptarë nga Kosova nuk ishin më të nevojshme, si për rastin e autorëve nga Shqipëria, analizime krahasimtare të *rrafshit diakronik*, që sjellin pamje të përkthimit të kësaj letërsie drejt gjuhëve të Europës para viteve '90.

Kjo ngaqë, pavarësisht se e kemi të bëjmë me të njëjtën gjuhë dhe gjendemi brenda të njëjtit etnos, Shqipëria e Kosova kanë përjetuar situata të ndryshme historike, shoqërore, kulturore e politike. E megjithëse tradicionalisht letërsia shqipe që shkruhet në Kosovë është këqyrur, por edhe e ka parë veten si pjesë përbërëse të letërsisë shqipe që shkruhet në Shqipëri (duke botuar me përparësi

3. Deleuze, Gilles, and Felix Guattari. *Kafka: Toward a Minor Literature*. Minneapolis and London: University of Minnesota, 1986.
4. Jana Bukova, *Not Small. Minor*. Studi Slavistici xi (2014): fq. 227-235.

e përkushtim jo vetëm klasikët e shqipes, por edhe autorë të ndaluar, qoftë haptas, qoftë heshturazi, në Shqipëri), letërsia kosovare ka mjaftueshëm veçanti që të mund të hulumtohet, të paktën brenda një studimi të tillë, më vete.

Një shqyrtim i tillë do ishte i dobishëm nëse prej tij do të mblidheshin të dhëna statistikore mbi rolin e mërgimit në procesin e përkthimit, mbi shkrimtarët e diglosisë pas emigrimeve të viteve '90, viteve '90 apo pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, si dhe ata shkrimtarë me kombësi shqiptare e prejardhje nga Kosova, të cilët janë lindur në vendet e BE-së dhe që sot shkruajnë në gjuhët e vendeve të BE-së.

Një nga ndodhitë e reja dhe pozitive që përjetojnë sot shkrimtarët shqiptarë të Kosovës, sidomos të brezit më të ri, është hapja dhe hyrja në marrëdhënie të pavarur me pjesën kulturore të Europës, duke u bërë pjesëmarrës në festivale ndërkombëtare dhe fitues të bursave për rezidenca letrare në vende të BE-së, të cilat ofrojnë mundësi për njohje me përkthyes e botues të atyre gjuhëve.

Përvoja të tilla, si ajo e pjesëmarrjes në festivalin "Review of Small Literatures" (Zagreb)[5], kanë njohur autorë si Ervina Halili, Arben Idrizi, Halil Matoshi, Ardian Haxhaj, Avni Rudaku, Shpëtim Selmani, Shkëlzen Maliqi, Genc Kadriu, Jeton Neziraj, Ballsor Hoxha, Qerim Ondozi apo edhe Azem Deliu në rezicencën letrare në Poloni[6] etj., duke bërë që këto prezantime t'i shërbejnë ndërkombëtarizimit të letërsisë së këtyre autorëve dhe të letërsisë së re[7] nga Kosova në rajon dhe në vendet e BE-së.

Përveç kritereve të sipërshënuara, një ndarje e vlefshme tipologjike, që shërbeu edhe për studimin e autorëve shqiptarë nga Kosova, ishte *zona e gjeografisë kulturore* që përfshin:

---

5. http://www.arkivalajmeve.com/Njembedhjete-shkrimtare-ne-Zagreb.1047104527/

6.https://www.kultplus.com/libri/shkrimtari-ri-nga-kosova-pjese-e-programit-artist-residence-ne-poloni/

7. Togfjalëshi "letërsi e re" është përdorur nga pikëpamja kronologjike.

— *kultura kufitare* (vende / shtete fqinjë si Serbia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Hungaria, me prani të emigracionit të herët a të vonë, që ka mjaft kontribute, por nuk është ende një faktor kulturor);

— *kultura me kufi të përbashkët kulturorë* (vendet fqinjë dhe jo fqinjë, me prani të grupeve etnike dhe pakicave kombëtare, si Maqedonia e Veriut apo Mali i Zi, diasporat e hershme, si Gjermania, Zvicra apo Italia, të cilët kanë qenë (janë ose mund të jenë) një faktor ndihmës, apo me rol e ndikim të ndjeshëm në përkthimtarí ose shkrim dygjuhësh);

— *kultura gjeografikisht më të largëta* të kontinentit europian, ku përfshihen shtetet gjeografikisht më të largët, si Suedia, Danimarka, Norvegjia etj., ku faktorët e parë nuk janë të qenësishëm dhe ku përkthimi përmes një *gjuhe-urë* është disi më i pranishëm[8].

Përmes kësaj optike, kriteresh klasifikuese dhe termash, edhe kjo pjesë e studimit ka synuar të qartësojë logjikën, synimet, shtysat dhe arsyet e përkthimit të veprave letrare të autorëve shqiptarë nga Kosova drejt gjuhëve të vendeve të BE-së dhe të Ballkanit Perëndimor.

Sipas analizimit të të dhënave, me gjithë disa dallime, që vijnë për shkak të konteksteve të ndryshme sociale e kulturore, arsyet motivuese të përkthimit të letërsisë shqipe nga Kosova mbeten përgjithësisht pó ato me të autorëve të Shqipërisë:

a. për shkak të kërkesës *komerciale në vend;*

8. Vërejmë se në shtetet që përfshihen në këtë kategori ka patur që herët prani të konsiderueshme emigrantesh nga Kosova , të cilët janë të organiuar dhe, si të integruar në jetën e vendeve ku jetojnë, kanë pasur dhe kanë ndikim në aspektin politik dhe ekonomik. Prania e hershme e këtij emigracionit ka ndikuar pozitivisht por, me potencialet që zotëron, mund të kishte qenë edhe më shumë i frytshëm, për të pasur një numër më të lartë përkthyesish apo përkthimesh dhe rritje të nivelit të shkëmbimeve letrare për letërsinë shqipe, si për atë që shkruhet në Shqipëri, ashtu edhe për atë që shkruhet në Kosovë, Maqedoninë e Veriut apo kudo në diasporë.

b. për shkak të *kritereve estetike* të përfaqësimit;

c. për shkak të përkimeve apo *përputhjes së kodeve* (stereotipeve) të kulturave pritëse, si formë e *eksportit letrar* dhe *pritshmërisë ekzotike* që ekziston ndaj letërsisë shqipe në vendet e BE-së dhe Ballkani Perëndimor (ku dhe tiparet e ngjashmërisë historike e kulturore janë më të afërta).

Përmes vëzhgimit të fundit (c) është synuar të kuptohet nëse niveli i shkëmbimit të kulturave përmes përkthimit letrar është më i lartë mes vendeve me histori e tipare kulturore të afërta e të përbashkëta (Ballkani Perëndimor) apo ky shkëmbim, për shkak të faktorit *superfuqi ekonomike e kulturore*, ka qenë më i lartë mes vendeve të BE-së.

Vend të veçantë edhe në këtë pjesë të studimit zënë përkthyesit, veçuar sipas kriterit *përkthyes vendas / i huaj*, që e kanë shqipen *gjuhë amtare* apo *gjuhë të mësuar,* duke synuar kësisoj të veçojmë fenomenin e përkthimit nga *gjuhë të dyta (urë*) apo *vetëpërkthimet*. Këtyre u shtohen, qoftë edhe me raste fare të pakta, disa autorë shqiptarë nga Kosova, që shkruajnë në gjuhë të huaja, si Beqë Cufaj, Hamit F. Gurguri, Rizah Sheqiri, Pajtim Statocvi etj.

Edhe kjo pjesë e studimit përmban skeda, referenca, indeks të brendashtuar tabelave mbi përkthyesit, shtëpitë botuese, revistave letrare dhe referencave të tjera lidhur me botimet dhe përkthimin, të cilat mbështesin tërthorazi propozimet, sugjerimet dhe rekomandimet.

2. Synimet

Krahas të argumenteve të tjerë, që u përshkruan në krye, edhe kjo pjesë e projektit synon krijimin e një baze të dhënash, të cilat janë të rëndësishme jo thjesht për burimet statistikore.

Nga kjo bazë të dhënash mund të fillojnë analizime të gjera e të shumanëshme që do të lehtësonin arritjen e disa përfundimeve ndihmëse mbi gjendjen dhe projektimin e një të ardhmeje më të frytshme në përkthimin e letërsisë së shkruar në gjuhën shqipe që vjen nga Kosova e që pret të përkthehet në gjuhët e vendeve të Bashkimit Europian dhe Ballkanit Perëndimor. Prej këtej synohet që të bëhen të dukshme shkaqet subjektive (mungesa e përkthyesve) apo shkaqet objektive (mangësi në politikat institucionale kulturore ndaj përkthimit), në kufi të zonës kohore (2015-2021), me qëllim që studimi t'i shërbejë në të ardhmen aktorëve të përfshirë në procesin e përkthimit, të tillë si hartuesit dhe zbatuesit e politikave kulturore lidhur me librin dhe përkthimin, institucionet e ngarkuara me mbështetjen dhe financimin apo qarkullimin e librit, si në Ballkanin Perëndimor, ashtu edhe vendet e BE-së e më gjerë, po aq sa edhe njësive të tjera kulturore, zyrtare ose jo, që pjesë të punës së tyre kanë përgatitjen apo kualifikimin e përkthyesve letrarë, si katedrat e gjuhëve të huaja etj.

3. Kategori dhe kritere

Sipas kategorizimeve të mëposhtme, ky studim i merr të klasifikuar zhanret sipas *rendit taksonomik* në vijim, sikurse edhe autorët i vendos sipas përkatësisë së tyre përballë *zonave të shkëmbimit përkthimor*:

a)

- Roman
- Prozë / Tregime
- Poezi
- Teatër / Dramaturgji
- Eseistikë
- Antologji poezish

- Antologji prozash
- Studime kulturore e sociale
- Studime kulturore e historike
- Biografi
- Autobiografi
- Kujtime
- Gjuhësi
- Fe / Besime

b)

- Autor *i përkthyer në zonën e shkëmbimit të lartë*;
- Autor *i përkthyer në zonën e shkëmbimit të mesëm*;
- Autor *i përkthyer në zonën e shkëmbimit të ulët*;

4. Përmbajtja e studimit

Burime të dhënash: këtu bëjnë pjesë të dhëna nga bibliotekat kombëtare dhe ndëreuropiane, nga portalet e specializuara, site-t e shtëpive botuese, të librarive me përhapje globale, të disa përkthyesve, të botuesve të veçantë, të revistave letrare e kulturore, këshillime për të dhëna shtesë a saktësime nga përkthyes e autorë;

a: Tabela: janë përdorur tabela modelore të ngjashme me skedat e përdorura nga kataloguesit vendas dhe ndërkombëtarë, në të cilat gjejnë pasqyrim të dhënat thelbësore dhe më të rëndësishme për botimin (të tilla si autori, përkthyesi, gjuha e përkthimit, botues, viti i përkthimit etj.).

b:Vëzhgime dhe Analizime: të dhënat e materialit të mbledhur plotësohen me vëzhgime e analiza mbi veçori të letërsisë të shkruar në gjuhën shqipe nga autorët e Kosovës dhe përkthimin e saj në gjuhët e vendeve të rajonit apo të BE-së.

c: Sugjerime / Parashikime / Këshillime / Propozime: Ky zë vjen si nevojë për cilësi më të lartë letrare në përzgjedhjen e librave dhe shmangie të subjektivitetit në procesin e përkthimit dhe të mbështetjes së përkthimit.

II. Vëzhgime cilësore

Vëzhgim panoramik dhe analizë e të dhënave

Në bazë të të dhënave që kemi gjetur, prania e autorëve që shkruajnë shqip dhe që kanë jetuar, ose jetojnë në Kosovë a në vende të tjera të Bashkimit Europian apo në rajon (ku identifikohen ose paraqiten si *autorë nga Kosova* apo *kosovarë*) nuk është e pakët, sidomos po të kemi parasysh historinë, veçantitë dhe ecurinë e letërsisë së shkruar nga autorët kosovarë qysh nga fillimet e deri në ditët tona.

Duhet theksuar fakti se e emërtuara *letërsi kosovare*, deri në fillimin e viteve '90, mezi hynte edhe brenda kufijve politikë të Shqipërisë, ndonëse shkruhej shqip. Hapësira zyrtare e librit e trajtonte heshturazi letërsinë kosovare si bartëse të mangësive ideologjike e politike, të ndikuar nga rrymat dhe lëvizjet moderniste europiane, të cilat realizmi socialist nuk i pranonte dhe nuk i lejonte të shfaqeshin për lexim publik.

Para se disa prej autorëve kosovarë t'u lejohej botimi në Shqipëri, librat e tyre gjendeshin vetëm në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë, në Bibliotekën e Fakultetit të Histori-Filologjisë, apo në ndonjë bibliotekë tjetër të kontrolluar nga shteti, për lexim të kufizuar.

Duhet theksuar gjithashtu se letërsia shqiptare e Kosovës, në vlerat përfaqësuese kishte paknjashmëri me letërsinë që shkruhej në Shqipëri, pasi njëherazi me disa liri të natyrës estetike e stilistike, në krahasim me letërsinë e realizmit socialist, që sundonte në Tiranë, kjo letërsi kishte veçanësitë e madje edhe epërsitë e një letërsie që nuk kufizohej prej dogmave të realizmit socialist e që ideologjikisht mund të "kalonte" vetëm përmes hermetizmit.[9]

9. Nuk bëhet fjalë për hermetizmin si lëvizje e botëkuptim letrar, por për një stil që nuk e vinte censurën komuniste në vështirësi.

Mund të thuhet se letërsia kosovare ishte një letërsi mes dy censurash dhe që, për shkak të gjuhës dhe kulturës së përbashkët, vlerësonte e shpesh merrte për modele vepra / autorë të realizmit socialist të Shqipërisë.

Deri në ndryshimin e regjimit në Shqipëri, përmes hullive të përhapjes së librit që vepronin në ish-Jugosllavi, disa autorë kosovarë u përkthyen e u botuan në gjuhë të rëndësishme të Europës Perëndimore, përfshi edhe gjuhët sllave brenda apo jashtë ish-Federatës Jugosllave. Një rast i mirënjohur është ai i poetit, prozatorit dhe eseistit Ali Podrimja (1942-2012), vepra e të cilit është përkthyer në mbi 20 gjuhë, qofshin ato të Ballkanit, qofshin të BE-së e më tej, dhe është vlerësuar si ndër më përfaqësueset e letërsisë shqipe në përgjithësi.[10] Ali Podrimja ishte edhe autori më i pranishëm në tubime letrare e festivale ndërkombëtare, si dhe laureat i disa çmimeve të rëndësishme, si Nikolaus Lenau (Shtutgart, 1999).[11]

Dëshmi të shumta nxjerrin në pah se Ali Podrimja, ndonëse nuk ishte një *autor-qendër* siç është përdorur koncepti në këtë studim, dha ndihmesë të madhe në përhapjen e letërsisë shqipe nga Kosova.

Ndryshimet e thella shoqërore që ndodhën gjatë viteve '90, e detyruan letërsinë kosovare të përshtatej me kushte jo krejt të panjohura të tregut të librit, por pa mbështetjen e një shteti të caktuar.

Autorët e njohur jashtë shqipes vazhduan të përkthehesin e të botoheshin më tej në Europë. Atyre iu shtuan disa autorë të rinj, veçmas në dramaturgji, prozë të tipit historik, si dhe poezi, librat e të cilëve përqendroheshin kryesisht në trandjet historiko-politike të kosovarëve, brenda kufijve të hershëm, të rinj dhe në mërgatë.

Siç vërehet nga tabelat, skedat, grafikët, listat emërore dhe të dhënat bibliografike bashkëlidhur këtij studimi, disa autorë nga

10. Shih: http://www.ashak.org/?cid=1,28,35.
11. Shih: https://www.literaturfestival.com/autoren/autoren-2010/ali-podrimja/

kjo hapësirë kanë krijuar tashmë një profil të qartë, të pranueshëm dhe të vlerësuar nga qarqe të caktuara letrare jashtë shqipes.

Ndërkaq, në radhë të parë edhe autorë kosovarë me banim jashtë trojeve, herë përmes vetëpërkthimeve, herë përmes përkthimeve e herë duke shkruar drejtpërdrejt (vetëpërkthime apo krijimtari e shkruar në gjuhët e vendeve ku jetojnë), botojnë me të njëjtin ritëm dhe ndihmojnë në përkthimin dhe botimin e autorëve bashkëkombas, me të cilët i lidh së pari niveli letrar dhe tematika.

Në gjuhët e huaja të shqyrtuara në këtë studim, prania e autorëve me vlera të verifikuara e kapërcen sasinë e autorëve / librave të hartuar kryesisht nën ndikimin e recetave që mund të sigurojnë sukses (komercial, imazhistik apo të dy bashkë). Kësisoj letërsia kosovare ka një prani e pamje më cilësore në krahasim me letërsinë e Shqipërisë, ku shumë autorë, - ndoshta edhe për shkak të numrit më të madh të botimeve, por edhe për shkak të natyrës së promovimeve, - ngulmojnë të dalin / përfshihen në sa më tepër gjuhë të huaja, ndonëse, pas të paktën tridhjetë vjetësh, pala që synon të përkthehet / botohet jashtë dhe pala që përkthen / boton duhet dhe mund të bënin një ndarje të qartë e frytdhënëse mes kriterit estetiko-artistik dhe shpërdorimit apo qasjes së nxituar ndaj paradigmave *letërsi, shkrimtar, vepër letrare*.

Gjatë viteve 2015-2020, si periudhë kohore e shqyrtuar në këtë studim, prania e autorëve kosovarë në gjuhët e huaja është në rritje nga viti në vit, pavarësisht faktit se pjesa më e madhe e tyre vijnë nga zona e shtypit të përditshëm dhe atij kulturor, ndërsa një pjesë tjetër vjen nga zona në kufij me letërsinë apo me aferi domethënëse me zona të tilla si politika, diplomacia, punonjësi publik.

Bie në sy rëndësia, apo vëmendja e shtuar që botuesit e huaj, brenda apo jashtë Bashkimit Europian, u kushtojnë autorëve tashmë klasikë të letërsisë kosovare, shumica e të cilëve nuk jetojnë e, rrjedhimisht, nuk mund të përpiqen drejtpërdrejt për botime në gjuhë të huaja.

Kjo e dhënë, siç vërehet përmes skedave të botimit, është një tipar për t'u nënvizuar dhe që tërheq vëmendjen, sidomos për autorë si A. Podrimja (rumanisht, polonisht, maqedonisht), E. Mekuli (polonisht), A. Shkreli (rumanisht, turqisht), por edhe të tjerë, në veprimtari të vazhdueshme, si R. Qosja (italisht, polonisht, hungarisht, rumanisht), E. Basha (frëngjisht, polonisht, rumanisht) etj.[12]

Nga ana tjetër, vërejmë se revista të ndryshme të gjuhës gjermane kanë në vëmendje letërsinë e re shqiptare që shkruhet në Kosovë. Sikurse në rastin e letërsisë nga Shqipëria kjo vëmendje lidhet me emrin e përkthyeses Zuzana Finger. Falë punës së saj të përkushtuar autorë si Xhevdet Bajraj, Doruntina Basha, Donika Dabishevci, Blerina Gaxha Rogova, Ervina Halili, Arben Idrizi, Eli Krasniqi, Jeton Neziraj, Kujtim Paçaku, Ardiana Shala Prishtina, Shpëtim Selmani, Ndriçim Ademaj etj., botuan në revista të njohura gjatë periudhës së marrë në shqyrtim nga ky studim.

Në vijim, tabela përmbledhëse me frekuencën e përkthimit të autorëve shqiptarë nga Kosova, përkthyer në gjuhët e shqyrtuara për efekt të këtij studimi, paraqet dhe, përtej nevojës për analizim apo shpjegime të mëtejshme, bëhet pasqyrë e vetvetes, duke i bërë të dukshme jo vetëm prurjet, por edhe nevojat dhe mungesat e hasura gjatë procesit.

12. Në Revistën Haemus dhe në Shtëpinë Botuese *Librarium Haemus*, për shembull, gjatë periudhës 2000-2020 janë botuar rumanisht pjesë dhe krijime të plota të mbi 35 autorëve nga Kosova, shoqëruar gjithmonë me të dhëna bibliografike (mes tyre A. Pashku, A. Shkreli, B. Musliu e të tjerë më pak të njohur). Libra të plotë (zhanret: antologji autori, roman, kujtime, dramaturgji, poezi) janë botuar nga autorët A. Podrimja, B. Sefaj, A. Zeneli, J. Neziraj, A. Vinca, K.M. Shala, D. Ibrahimi. Të dhëna më të plota gjenden brenda këtij studimi.

Frekuenca e përkthimit nga gjuha shqipe në gjuhët e studiuara

Nr. i titujve	Vendi	Gjuha
13	Itali	Italisht
13	Suedi	Suedisht
11	Serbi	Serbisht
11	Angli	Anglisht[13]
9	Francë	Frëngjisht
3	Bullgari	Bullgarisht
3	Maqedoni e Veriut	Maqedonisht
2	Rumani	Rumanisht
2	Slloveni	Sllovenisht
1	Hungari	Hungarisht
1	Gjermani	Gjermanisht
1	Spanjë	Spanjisht

13. Nga letërsia e Kosovës janë përkthyer e botuar në anglisht 11 tituj.

Disa përfundime:

1. Nga të dhënat del se mes viteve 2015 dhe 2020 librat e autorëve nga Kosova janë përkthyer kryesisht në gjuhë të vendeve me frekuencë të mesme e të lartë shkëmbimi (italisht, suedisht, serbisht, anglisht, frëngjisht). Në gjuhët e kulturave të afërta gjeografikisht apo kulturalisht, librat e autorëve nga Kosova janë përkthyer më pak. Kjo vjen ndoshta ngaqë në hapësirat e sapopërmendura letërsia nga Kosova njihet në njëfarë mënyre tradicionalisht, falë përkthimeve e botimeve të periudhës 1960-2010. Nga ana tjetër, këto hapësira duket se nuk përbëjnë *target* të posaçme për autorët, përkthyesit dhe botuesit që veprojnë në fushën e qarkullimit të letërsisë kosovare jashtë kufijve;

2. Vlen të theksohet se synimet për të qenë sa më të pranishëm në tregun europian të librit, për botimet në gjuhë të qarkullimit të gjerë e jo thjesht rajonal, janë një shenjë e mirë dhe, gjykuar nga veprimtaritë e deritashme, do të ngjitet hap pas hapi, duke dhënë një pamje të besueshme dhe me vlera estetiko-artistike të letërsisë shqipe që shkruhet në Kosovë;

3. Vihet re, gjithashtu, se përzgjedhja e librave dhe e autorëve kryhet nga qarqet përkatëse me përgjegjshmëri dhe me respekt ndaj traditës letrare të Kosovës. Dëshmi për këtë janë titujt e përkthyer, si edhe shumica e autorëve, që janë themeltarë për letërsinë e shkruar në gjuhën shqipe në Kosovë;

4. Si në letërsitë e tjera ballkanike, edhe letërsia shqipe nga Kosova niset drejt gjuhëve e kulturave të BE-së e më gjerë me libra e autorë që janë në afirmim e sipër dhe që, veç vlerave të brendshme, gëzojnë edhe mbështetjen e nevojshme zyrtare

nga rrjete e institucione kulturore dhe / ose diplomatike nga vetë vendet e BE-së dhe të Ballkanit Perëndimor;

5. Mund të vërehet, gjithashtu, se prania e autorëve kosovarë nëpër tubime letrare, festivale, antologji apo rezidenca letrare / përkthimore jashtë kufijve, përfshi Shqipërinë, është e kënaqshme dhe sjell vlera;

6. Sa u përket përkthimeve nga letërsia në gjuhën shqipe në Kosovë, një rol të madh ka luajtur e luan organizimi prej Institutit Albanologjik[14] i Seminarit të Albanologjisë (në vitin 2021 u mbajt për herë të 39-të), ku veç shkencëtarëve, ftohen dhe marrin pjesë edhe përkthyes nga Europa, një pjesë e të cilëve përkthejnë letërsi nga Kosova;

7. Vlen të përmendet edhe fakti që shtëpitë e mëdha botuese kosovare kanë në redaksitë e tyre jo vetëm shkrimtarë me emër, por edhe kritikë, studiues e akademikë, çka ndikon që cilësia e botimeve e, rrjedhimisht edhe e librave për përkthim, të jetë e lartë.

14. https://www.institutialbanologjik.com/index.aspx-?LID=2&SID=1&AID=1&Ctype=1&ACatID=1

Conclusions:

1. The data show that between 2015 and 2020, books by Kosovo authors were mostly translated into the languages of countries with medium and high frequency of exchange (Italian, Swedish, Serbian, English, and French). In languages of geographically or culturally close cultures, books by Kosovo authors have been less translated;

2. This is probably because in the areas just mentioned, Kosovar literature is traditionally known, thanks to translations and publications from the period 1960-2010. On the other hand, these spaces do not seem to be specific targets for authors, translators and editors operating in the field of circulation of literature from Kosovo abroad;

3. It is worth noting that the intentions of being present as much as possible in the European book market, for publications in widely used languages and not only regional ones, are a good sign and, judging by the activities carried out so far, it will show a credible and aesthetic-artistic vision of literature form Kosovo;

4. It is also noted that the selection of books and authors is carried out by the respective circles with responsibility and respectfully for the literary tradition of Kosovo. An evidence of this are the translated books, as well as most of the authors, who are the promoters of literature from Kosovo;

5. As in other Balkans and Eastern literatures, literature from Kosovo also launches itself towards community

languages and cultures and beyond books and authors, who are affirming themselves and who, in addition to internal values, enjoy the necessary official support from cultural networks and institutions and / or diplomats of the EU and the Western Balkan countries themselves;

6. It can also be noted that the presence of authors from Kosovo in literary events, festivals, anthologies or literary / translation residencies abroad, including Albania, is satisfactory and valuable;

7. As for translations from literature form Kosovo, but also Albanian in general, a great role has the organization of the Albanology Seminary of (in 2021 it was 39th edition) by the Albanological Studies Institute, attended by scientists, researchers, translators and writers from all over the world, some of whom have been translating from Kosovar literature for years;

8. It should be noted that the great publishing houses in Kosovo have in their editorial offices not only established writers, but also critics, scholars and academics, which affects the quality of the publications and consequently of the books intended for translation.

Rekomandime:

Për një rritje më të ndjeshme të cilësisë dhe të pranisë së letërsisë kosovare në gjuhët e vendeve të BE-së dhe të Ballkanit Perëndimor, mendojmë se nevojitet (ose duhet dendësuar):

1. Mbështetja më e madhe nga Ministria e Kulturës dhe entet e tjera të përfshira në veprimtarinë e përkthimit të librit shqip të autorëve nga Kosova në përkthimin dhe promovimin e letërsisë kosovare edhe në hapësirat me frekuencë të ulët shkëmbimi, ku kjo letërsi është pak e njohur, ose e panjohur, duke u njësuar shpesh me letërsinë shqipe të brenda kufijve të Shqipërisë;
2. Parashikim më i lartë fondesh për ftesa ndaj përkthyesve të huaj që përkthejnë letërsinë shqipe të shkruar në Kosovë drejt të vendeve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, për t'iu krijuar atyre kushte e mundësi periodike pune dhe njohjeje me skenën letrare dhe bashkëpunim me autorët;
3. Krijimi i një kalendari për organizime të planifikuara institucionale seminaresh kushtuar librit letrar, punëtorish përkthimore e konferencash kualifikuese në favor të përkthyesve të huaj, që përkthejnë letërsinë shqipe të shkruar në Kosovë drejt të vendeve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, të cilat do të shërbenin për shkëmbim përvojash dhe ndërtim perspektivash dhe politikash kulturore ndaj përkthimit. Ngjarjet e mësipërme do të duhet t'u drejtohen edhe përkthyesve që kanë për gjuhë amtare shqipen dhe që përkthejnë tashmë me nivel të lartë në gjuhë të huaja;
4. Themelimi i një çmimi të posaçëm letrar për përkthyesit që përkthejnë letërsinë shqipe të shkruar në Kosovë drejt të vendeve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, si dhe vlerësime

për ndërmjetësuesit, agjentët letrarë dhe mediatizuesit e librave të përkthyer nga autorët shqiptarë të Kosovës. Çmimet mund të jenë shprehje vlerësimi e mbështetjeje nga Ministria e Kulturës, Shoqata e Përkthyesve, Shoqata e Botuesve etj;

5. Parashikim i ofrimit të disa bursave (scholarship) një apo disa mujore për rezidenca letrare ndaj përkthyesve, me gjuhë amtare shqipen apo të huaj, por që përkthejnë letërsinë shqipe të shkruar në Kosovë drejt të vendeve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor;

6. Ndonëse prania e letërsisë shqipe nga Kosova në panairet e librit dhe në tubime të tjera letrare ndërkombëtare është e organizuar, mund të hidhen hapa drejt një promovimi më të gjerë, sidomos në panaire ndërkombëtare librit, festivale, takime me autorë të veçantë dhe me përkthyes, me synim një ndërkombëtarizimin e letërsisë shqipe të shkruar në Kosovë;

7. Aktivizim e bashkëpunim më frytdhënës të fushës së librit me sektorin kulturor apo nëpunësit e ambasadave të Kosovës në vendet e BE-së dhe të Ballkanit Perëndimor, për njohjen e autorëve nga Kosova;

8. Publikimi i një katalogu shumëfunksional (përfshi curriculum profesional) me emrat e përkthyesve të huaj dhe shqiptarë, që përkthejnë nga gjuha shqipe drejt gjuhëve të vendeve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor;

9. Interesim më i madh i vetë autorëve nga Kosova ndaj ftesave për rezidenca letrare, në dobi të ndërkombëtarizimit të letërsisë në gjuhën shqipe që shkruhet në Kosovë, si dhe për një njohje më të mirë të kësaj letërsie nga kolegët e letërsive të tjera dhe përkthyesit e tyre.

Recommendations:

For more quality and presence of Kosovar literature in the languages of EU and Western Balkan countries, we think that it is necessary (or should be intensified):

1. Greater support from the Ministry of Culture and other factors involved in the translation activity of the Albanian book by the Kosovo's authors, for the translation and promotion of literature from Kosovo also in the low-frequency exchange spaces, where such literature is less known, or unknown, often identified with Albanian literature within the borders of Albania;
2. An increased allocation of funds for invitations to foreign translators who translate Albanian literature written in Kosovo in the EU countries and the Western Balkans, to provide them with periodic job opportunities and knowledge of the literary scene and collaboration with authors;
3. To establish a calendar for the planned institutional organization of seminars dedicated to the literary book, translation workshops and qualification conferences for foreign translators, which translate Albanian literature written in Kosovo to EU countries and the Western Balkans. This will be helpful for the exchange of experiences and the construction of cultural perspectives and policies on translation. The above events should also be addressed to translators who have Albanian as their mother tongue and who are already translating at a high level into foreign languages;
4. To create a special award for foreign translators, brokers and book brokers who translate from literature from

Kosovo. The awards can be an expression of appreciation and support from the Ministry of Culture, the Association of Translators, the Association of Publishers, etc.;

5. Provision to offer one or more monthly scholarships for literary residencies to literary translators, both in their mother tongue and in Albanian, which allows them to work directly with authors and publishers form Kosovo;
6. Although the presence of literature from Kosovo in book fairs and other international literary gatherings is organized and valuable, steps can be taken towards wider promotion, especially in international book fairs, festivals, meetings with special authors and translators, aiming to a more complete internationalization of Albanian literature written in Kosovo;
7. A more fruitful collaboration in the field of books with the cultural sector or the staff of the Kosovo Embassies in EU and WB countries, for the internationalization of authors from Kosovo and their translators in EU and WB languages;
8. Publication of a multifunctional catalog (including professional curriculum) with the names of foreign (and local) translators who translate from Albanian to the languages of EU countries and the Western Balkans;
9. Greater interest of authors from Kosovo to the literary residences, for the benefit of the internationalization of literature in the Albanian language written in Kosovo, as well as for a better knowledge of this literature by colleagues of other literatures.

Bibliografi e zgjedhur

1. Albanian Liteature:www.albanianliterature.net
2. Andoni, B.: Albania's Literary Treasures Lost in Translation; https://balkaninsight.com/2010/06/23/albania-s-literary-treasures-lost-in-translation.
3. Biblioteka e Akademisë Rumune: www.biblacad.ro
4. Biblioteka e Kongresit Amerikan: www.loc.gov
5. Biblioteka Kombëtare e Rumanisë: www.bibnat.ro
6. Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë: www.bksh.al
7. Brad, I., Poeți greci contemporani – Antologie, Ed. Pegasus Press, Bukuresht 2003
8. Bukova, J.: Not Small. Minor. Studi Slavistici xi (2014): fq. 227-235.
9. Gazeta Mapo, 14.04. 2018: *Përkthyesi norvegjez, Jon Kvaerne*: Udhëtimi në Ballkan dhe "nami" i shqiptarëve. https://gazetamapo.al/perkthyesi-norvegjez-jon-kvaerne-udhetimi-ne-ballkan-dhe-nami-i-shqiptareve/.
10. Genesin, M.: *Self-Translation In Translingual Writing:* Luan Starova's Albanian and Macedonian versions of the novel 'The Times of the Goats', Lingue Linguaggi 33 (2019), fq. 101-108.
11. Gilles, D.; Guattari, F., *Kafka: Toward a Minor Literature*. Minneapolis and London: University of Minnesota, 1986.
12. Elsie, Robert: www.elsie.de
13. Halla, B.: Albanian Literature Beyond Kadare's Long Shadow: https://exit.al/en/2021/10/12/comment-albanian-literature-beyond-kadares-long-shadow/

14. Kyçyku, A.: (shqip e rumanisht) www.arkycyku.info, www.kuciuk.blogspot.ro

15. Kyçyku, A.: Trialog [Ese ndërdisiplinore mbi lidhjet e letërsisë me mërgimin dhe me gjuhët që ajo zgjedh për të ruajtur Kujtesën dhe Metaforën], Librarium Haemus 2016.

16. Kyçyku, A.: *Disa veçanti të botimeve shqip në Hapësirën Rumune, studim i paraqitur në Éditer en albanais dans un contexte allophone*. Séminaire Réseau transnational pour l'étude de la presse en langues étrangères (Transfopress), INALCO, BULAC, Paris, 2019.

17. Kyçyku, K.: www.kkycyku.blogspot.com

18. Leka, A.: Në kërkim të këmishës së humbur: Provinc. Autonome/Letërsi fason (Një kor autorësh përballë autorit-qendër), f. 322, Botimet Poeteka, Tiranë, 2018.

19. Leka, A.: An Autonomous Province", Herito, Nr. 30/1/2018, f. 78-91; Në kërkim të këmishës së humbur", Botimet Poeteka, 2018, fq. 313-330.

20. Librarium Haemus Editions: www.librarium-haemus.blogspot.com

21. Marrëveshja e Ohrit / Maqedonia e Veriut si një shtet multietnik, ndëretnik dhe ndërfetar, mbi respektimin e identitetit kulturor të të gjithëve dhe të drejtat e barabarta të çdo qytetari, pavarësisht përkatësinë etnike.

22. Revista Haemus: www.revistahaemus.blogspot.com

23. Revista Poeteka: www.poeteka.blogspot.com

24. Revista Transkript: https://www.transcript-review.org

25. Roehm, Joachim: http://www.joachim-roehm.info

26. Shoqëria Kulturore Shqiptare Haemus: www.ahaemus.blogspot.com

27. Starova, L.: Edhe kur shkruaj në gjuhë të tjera, veprat e mia frymëmarrjen e kanë shqip, Exlibris, 24 Prill, 2021.
28. Starova, L.: Një miqësi europiane: Faik Konica - Guillaume Apollinaire; përktheu Remzi Përnaska, Onufri, 2001.
29. TRADUKI: www.traduki.eu
30. Worldcat: www.worldcat.org

Burime të drejtpërdrejta:

1. http://www.nbcgdigitalnabibliografija.me/bibliografija_tekuca/knjige_2014/zapisi66.html
2. https://fr.wikipedia.org/wiki/Luan_Starova (Bibliographie: Ouvrages disponibles en français, regroupés en partie sous le titre de Saga balkanique).
3. https://poeteka.blogspot.com/p/poeteka17.html.
4. https://qkll.gov.al/rreth-qkll/misioni.
5. https://qkll.gov.al/rreth-qkll/vendimi-i-krijimit.
6. https://www.liwre.fi/wp-content/uploads/2019/06/1ArianLekaSUOMEKSI.pdf
7. https://www.sme.skç/598027çajka-a-plostice.html
8. https://en.unesco.orgçreativity/policy-monitoring-platformçooperation-agreement-between.

Grafiku i autorë shqiptarë
(nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Diaspora)
libra të përkthyer / ribotime / organe shtypi



Listë emërore e autorëve shqiptarë
(nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Diaspora)
libra dhe prani në organe shtypi

1 Adem Abdullahu
1 Adil Olluri
1 Agim Gjakova
1 Alb Elo
1 Albana Nexhipi
1 Albana Shala
1 Ali Aliu
1 Alisa Velaj
1 Anna Kove
1 Anton Pashku
1 Arben Atashi
1 Ardian Klosi
1 Ardian Marashi
1 Ardian Ndreca
1 A.-Ch. Kyçyku
1 Arqile Teta
1 Arta Arifi
1 Artan Arslani
1 Artan Minarolli
1 Arti Lushi
1 Asdren Çeliku
1 Avni Rudaku
1 Bardhyl Alia
1 Bedri Myftari
1 Belfjore Qose
1 Ben Apolloni
1 Besa Salihu
1 Blendi Fevziu
1 Blerina Goce
1 Blerina Suta
1 Daim Ilazi
1 Daut Dauti
1 Dom Simon Jubani
1 Driton Zenku
1 Dhimitër Xhuvani
1 Edi Rama
1 Edon Qesari
1 Eduart Sulollari
1 Ejup Ajdini
1 Eli Krasniqi
1 Elida Rusta
1 Elidor Mëhilli
1 Elinda Marku
1 Eljan Tanini
1 Elona Gjergo
1 Elona Zhana
1 Eni Kaçi
1 Eni Vasili
1 Enis Maci
1 Ernest Koliqi
1 Ervina Halili
1 Fadil Bajraj
1 Fahredin Shehu
1 Faik Ballanca
1 Fan Stilian Noli
1 Faslli Haliti
1 Fate Velaj
1 Fatos Arapi
1 Fatos Baxhaku
1 Fejzi Bojku

1 Fetah Bahtiri
1 Fetah Bahtiri
1 Fitore Demolli
1 Floresha Dado
1 Flurans Ilia
1 Frederik Rreshpja
1 Gentiana Minga
1 Gëzim Qëndro
1 Gresa Hasa
1 Grigor Banushi
1 Gjekë Marinaj
1 Gjergj Fishta
1 Gjovalin Kola
1 Heli Tahiri
1 Hiqmet Meçaj
1 Ibrahim Kadriu
1 Ilir Shyta
1 Ilirjana Selmani
1 Iljaz Bobaj
1 Jamarbër Marko
1 Juliana Janku
1 K. Th. Spiri
1 Kismete Hyseni
1 Kujtim Paçaku
1 Lazër Radi
1 Lazër Stani
1 Lea Ypi
1 Ledia Dushi
1 Lindita Ahmeti
1 Lindita Arapi
1 Lindita Komani
1 Liria Xhunga, Miro Xhunga
1 Lisiana Demiraj
1 Luan Topçiu
1 Luljeta Dano
1 Lumi Bekim
1 Majlinda Bregasi
1 Maku Pone
1 Manjola Brahaj
1 Manjola Nasi
1 Mihal Hanxhari
1 Mikaela Minga
1 Milazim Krasniqi
1 Mimoza Hasani Pllana
1 Mujo Buçpapaj
1 Murat Ajvazi
1 Naime Beqiraj
1 Nazmi Beqiri
1 Ndre Mjeda
1 Ndue Ukaj
1 Neritan Ceka
1 Novruz Xh. Shehu
1 Pal Sokoli
1 Parid Teferiçi
1 Petraq Risto
1 Pëllumb Kulla
1 Refet Abazi
1 Rexhep Shahu
1 Rezart Palluqi
1 Rifat Haxhijaj
1 Riza Ziberi
1 Romeo Çollaku
1 Rovena Sakja
1 Rudian Zekthi
1 Sabina Veizaj
1 Saimir Muzhaka

1 Sali Bashota
1 Sefer Selimi
1 Sterjo Spasse
1 Suadela Balliu
1 Sulejman Ajredini
1 Shaban Sinani
1 Shaip Emerllahu
1 Shpëtim Gina
1 Teodor Laço
1 Tom Kuka (Enkel Demi)
1 Thanas Jorgji
1 Thanas Medi
1 Valbona Gashi-Berisha,
Philippe Chardin
1 Vera Bekteshi
1 Virion Graçi
1 Visar Krusha
1 Xhabir Deralla
1 Xhelal Tosku
1 Xhemile Adili
1 Xhevahir Spahiu
1 Ylli Demneri
1 Zef Zorba
1 Zija Çela

2 Arben Idrizi
2 Ben Blushi
2 Besnik Mustafaj
2 Dan Ibrahimi
2 Darien Levani
2 Delvina Kërluku
2 Donika Dabishevci
2 Doruntina Basha
2 Eqrem Basha
2 Eqrem Çabej
2 Evalda Paçi
2 Fatos Lubonja
2 Grup autorësh
2 Grup autorësh
2 Helena Kadare
2 Ilirjan Zhupa
2 Jozef Radi
2 Lasgush Poradeci
2 Lulzim Tafa
2 Martin Camaj
2 Mimoza Hysa
2 Mira Meksi
2 Miranda Haxhia
2 Ornela Vorpsi
2 Petraq Kolevica
2 Ramiz Gjini
2 Ridvan Dibra
2 Rina Çela Grasset
(me Nathalie Carron-Lanzl)
2 Rita Petro
2 Rizah Sheqiri
2 Sadije Aliti
2 Silvana Berki

3 Anila Wilms
3 Ardian Vehbiu
3 Aurel Plasari
3 Diana Çuli
3 Dritëro Agolli
3 Elvira Dones
3 Entela Tabaku
3 Gjergj Jozef Kola
3 Kasam Shaqirvelaj

3 Luan Rama
3 Mariklena Niço
3 Mimoza Ahmeti
3 Resul Shabani
3 Rudi Erebara
3 Lulzim Tafa
3 Rexhep Qosja

4 Ardita Jatru
4 Flutura Açka
4 Gazmend Kapllani
4 Lira Bojku
4 Migjeni
4 Namik Dokle
4 Virgjil Muçi
4 Pajtim Statovci

5 Arjan Kallço
5 Mitrush Kuteli
5 Visar Zhiti
5 Xhevdet Bajraj

6 Veton Suroi

7 Bashkim Shehu
7 Bessa Myftiu
7 Fatos Kongoli
7 Luljeta Lleshanaku
7 Stefan Çapaliku
7 Hamit F. Gurguri
7 Jeton Kelmendi

11 Ylljet Aliçka

15 Jeton Neziraj

27 Luan Starova

34 Arian Leka

74 Ismail Kadare

Grafiku i frekuencës së përkthimeve nga shqipja në gjuhët e studiuara 2015-2020, përfshi prirjet e vitit 2021

Frequency of translation from Albanian into the studied languages (2015-2020) including trends (2021) Chart in English



Grafiku i frekuencës së përkthimeve nga shqipja në gjuhët e studiuara (autorë nga Kosova), 2015-2020, përfshi prirjet e vitit 2021



Tabela e ecurisë të përkthimeve nga autorët shqiptarë (2015-2020) dhe prirjet e tyre (2021)

The evolution of translations from Albanian Authors (2015-2020) and their trends (2021)

Chart in English

Place / Language	Year	Year	Year	Year	Year	Year	Tendeces
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
BiH / Bosnian	0	1	0	1	1	0	0
Bulgaria / Bulgarian	1	2	0	1	4	4	0
Croatia / Croatian	0	0	2	1	1	0	2
Czech Republic / Czech	1	0	1	0	0	0	0
Denmark / Danish	0	0	0	0	0	0	0
Finland / Finnish	0	0	1	0	1	0	0
France / French	3	7	8	9	10	1	3
Germany / German	1	3	0	1	1	3	1
Holland / Dutch	0	0	0	0	0	0	0
Hungary / Hungarian	0	1	0	0	0	0	0
Italy / Italian	6	7	11	9	16	13	12
Montenegro / Montenegrin	1	0	2	0	0	1	0
North Macedonia / Macedonian	17	6	9	9	10	9	4
Norway / Norwegian	2	0	1	0	0	0	0
Poland / Polish	0	0	1	1	1	1	0
Romania / Romanian	3	3	3	5	1	6	0
Serbia / Serbian	4	10	1	4	2	0	3
Slovakia / Slovak	0	0	1	0	0	0	0
Slovenia / Slovenian	0	3	1	0	0	0	0
Spain / Spanish	1	3	0	1	0	1	6
Sweden / Swedish	0	0	1	8	5	4	0

Grafiku i ecurisë së përkthimeve nga autorët shqiptarë (2015-2020) dhe prirjet e tyre (2021)

The evolution of translations from Albanian Authors (2015-2020) and their trends (2021)

Chart in English



Kyçyku, Ardian (përg.)

Letërsia shqiptare e përkthyer në gjuhët e vendeve të Bashkimit Europian dhe gjuhët e Ballkanit Perëndimor : të dhëna : vëzhgime : analiza : rekomandime : përkthyes : libra : botues : revista letrare / Ardian Kyçyku ; red. Astrit Beqiraj, Arian Leka. – Tiranë : Poeteka, 2021
124f. ; 16.5 x 23.5 cm.
Bibliogr.
ISBN 978-9928-230-47-8

1.Letërsia shqipe 2.Autorë shqiptarë 3.Përkthime 4.Studime

821.18 (048.83)

Co-funded by the
Creative Europe Programme
of the European Union

ISBN 978-9928-230-47-8